Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Mars 2019

**Tiranë, më 23 Prill 2019:** Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Mars 2019, janë 712.983 krahasuar me Mars 2018, ky tregues rezulton me rritje 17,4 %. Në Mars 2019, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 283.910, krahasuar me Mars 2018, ky numër është rritur me 11,8 %.
Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në tremujorin e parë 2019 është 695.027, duke u rritur keshtu 2,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në Mars 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, SHBA ka pasur rritjen më të madhe me 74,2 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Mbreteria e Bashkuar me 63,8 %.

Në tremujorin e parë 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë pasur rritjen më të madhe me 33,3 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Spanja me 23,8%.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri




**Për publikim 23/04/2019**

Vijon

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Mars 2019, janë 728.817 duke shënuar një rritje me 21,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2019, janë 444.828. Krahasuar me Mars 2018, ky numër është rritur 22,1 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2019, janë 283.989. Krahasuar me Mars 2018, ky numër është rritur 21,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në tremujorin e parë 2019, është 1,249,803 duke u rritur 12,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

| Periudha | Mars 2018 | Mars 2019 | Ndryshimi vjetor (%) | Janar-Mars 2018 | Janar-Mars 2019 | Ndryshimi vjetor (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Hyrje Gjithsej | **607.288** | **712.983** | 17,4 | 1.706.296 | 1.817.722 | 6,5 |
| Shqiptarë | 353.268 | 429.073 | 21,5 | 1.029.407 | 1.122.695 | 9,1 |
| Të Huaj | 254.020 | 283.910 | 11,8 | 676.889 | 695.027 | 2,7 |
| **Dalje Gjithsej** | **598.992** | **728.817** | 21,7 | **1.820.403** | **1.982.085** | 8,9 |
| Shqiptarë | 364.264 | 444.828 | 22,1 | 1.111.856 | 1.249.803 | 12,4 |
| Të Huaj | 234.728 | 283.989 | 21,0 | 708.547 | 732.282 | 3,3 |

### Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

| Shtetet | Mars 2018 | Mars 2019 | Ndryshimi vjetor (%) | Janar-Mars 2018 | Janar-Mars 2019 | Ndryshimi vjetor (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kosovë | 82.832 | 79.389 | -4,2 | 231.023 | 203.927 | -11,7 |
| Maqedoni | 35.407 | 45.464 | 28,4 | 97.664 | 104.898 | 7,4 |
| Greqi | 37.737 | 45.385 | 20,3 | 100.228 | 108.960 | 8,7 |
| Itali | 20.794 | 21.594 | 3,8 | 56.396 | 58.283 | 3,3 |
| Angli | 5.147 | 1.861 | -63,8 | 13.262 | 11.407 | -14,0 |
| Mali i zi | 32.345 | 34.889 | 7,9 | 80.718 | 80.499 | -0,3 |
| Poloni | 495 | 582 | 17,6 | 1.219 | 1.349 | 10,7 |
| SHBA | 3.870 | 6.741 | 74,2 | 10.144 | 13.527 | 33,3 |
| Spanjë | 863 | 494 | -42,8 | 1.640 | 1.249 | -23,8 |
| Gjermani | 4.557 | 2.707 | -40,6 | 9.467 | 7.951 | -16,0 |
| Zvicër | 1.298 | 1.437 | 10,7 | 3.858 | 3.989 | 3,4 |
| Të tjera | 28.675 | 43.367 | 51,2 | 71.270 | 98.988 | 38,9 |
| Gjithsej/Total | 254.020 | 283.910 | 11,8 | 676.889 | 695.027 | 2,7 |

## Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

| Periudha | Mars 2018 | Mars 2019 | Ndryshimi vjetor (%) | Janar-Mars 2018 | Janar-Mars 2019 | Ndryshimi vjetor (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Hyrje Shtetas të Huaj** | **254.020** | **283.910** | 11,8 | 676.889 | 695.027 | 2,7 |
| I. Personale | 247.543 | 276.068 | 11,5 | 660.780 | 674.805 | 2,1 |
| 1. Pushime, vizitë tek të afërm etj. | 235.630 | 262.419 | 11,4 | 630.251 | 643.145 | 2,0 |
| 2.Trajtim shëndetësor | 25 | 71 | 184,0 | 62 | 137 | 121,0 |
| 3.Qëllime fetare | 44 | 39 | -11,4 | 133 | 195 | 46,6 |
| 4.Udhëtarë transit | 11.844 | 13.539 | 14,3 | 30.334 | 31.328 | 3,3 |
| II. Biznes dhe profesionale | 6.477 | 7.842 | 21,1 | 16.109 | 20.222 | 25,5 |

## Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

| Periudha | Hyrje gjithsej | | | Dalje gjithsej | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ajër | Det | Tokë | Ajër | Det | Tokë |
| Mars 2018 | 97.923 | 25.212 | 484.153 | 93.320 | 22.247 | 483.425 |
| Mars 2019 | 103.433 | 28.298 | 581.252 | 102.288 | 36.464 | 590.065 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 5,6 | 12,2 | 20,1 | 9,6 | 63,9 | 22,1 |
| Janar-Mars 2018 | 275.902 | 67.001 | 1.363.393 | 284.981 | 87.527 | 1.447.895 |
| Janar-Mars 2019 | 294.662 | 72.586 | 1.450.474 | 309.427 | 104.959 | 1.567.699 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 6,8 | 8,3 | 6,4 | 8,6 | 19,9 | 8,3 |

# Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).
Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet** : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).
Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor**: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi "vizitor" nënkupton "një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse".

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:
*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm,etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/ politika e revizionimit statistikor.

**Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.